

## NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Themelore në Prizren** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e sekretarës juridike Mire Beqiraj, në lëndën penale kundër të akuzuarave: D. [redacted] dhe B. [redacted] E. [redacted] që të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 parag.2, lidhur me nenin 31, të KP, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/IL.nr. [redacted]/15, të datës 23.03.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në praninë e Prokurorit të Shtetit Musli Gashi dhe të akuzuarave, të dëmtuarit dhe deshmitarëve, me datë 08.03.2017, publikisht morri dhe shpalli këtë:

### AKTGJYKIM

#### Të akuzuarit:

D. [redacted] E. [redacted] nga i ati A. [redacted] dhe e ëma F. [redacted], me mbiemër vajzërie M. [redacted], i lindur me datë 30.06.1978, në Prizren, ku edhe tani jeton në rr. " [redacted] ", nr. 13, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, Shqipëtarë, Shtetas i Republikës së Kosovës.

B. [redacted] E. [redacted] nga i ati A. [redacted] dhe e ëma F. [redacted], me mbiemër vajzërie M. [redacted], i lindur me dt. 29.09.1985, në fsh. S. [redacted] KK Suharekë, tani me banim në Prizren, në rrugën „ [redacted] ”, nr. 13, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mirë ekonomike, me profesion tregëtarë, i martuar, Shqipëtar Shtetas i R. Kosovës.

### JANË FAJTOR

Se me datën 06.03.2015, rreth orës 14.50 min., në Prizren, në rrugën „ [redacted] ”, nr. 16, në bashkëveprim, seriozishtë i kanosen personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ti shkaktojn ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose shkakimit të ankthit, të dëmtuarit K. [redacted] M. [redacted], në atë mënyrë që derisa i njëjti ishte afër shtëpisë së tij se bashku me një person tjetër përshkak të një ndërtimit të një objekti në afërsi të shtëpisë së të pandehurëve në momentin kur takohen i kanosen me fjalët: „ bahu prej ketuhit, se kemi me të vra, dhe ketështëpi kurrë s'ka me gzu”, me q'rastë tek i dëmtuari shkaktojn ankth dhe frikë si dhe i'a rrezkojn sigurinë personale.

**Këso dore kanë kryer veprën penale kanosje nga neni 185 parag.2, lidhur me nenin 31, të KP.**

Gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 8, 9, 10, 17, 21, 41, 42, 43, 85, 86 nenit 188 par.1 pika 1.4 të KP dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarëve i'u shqipton:

### VËREJTJE GJYQSORE

Të akuzuarëve D. [redacted] dhe B. [redacted] E. [redacted], pasi që kanë kryer veprën penale, kanosje nga neni 185 parag.2, lidhur me nenin 31, të KP, veprën penale e cila është e rrezikshme dhe e dëmshme, të njëjtit nëse sërish kryen vepra të tillë, gjykata do ti shqiptoj dënim më të rëndë.

Obbligohen të akuzuarit që t'i paguajn shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor, se  
në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmëri së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

### Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.5/2015, të datës 23.03.2015, ushtruar kundër të akuzuarëve D. dhe B. që të dy nga Prizreni, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 185 parag.2, lidhur me nenin 31, të KP.

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në prezencën e palëve. U lexua aktakuza nga ana e Prokurorit të Shtetit, i shpalosi dhe bëri prezentimin e të gjitha provave materjale në të cilat mbështet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarëve. Të akuzuarit pas kësaj gjat shqyrtimit gjyqësor deklarojn se kanë kuptuar aktakuzën dhe të njëjtit e kanë pranuar fajësin dhe pranueshmërin e provave.

Prokurori i Shtetit Musli Gashi, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me vet pranimin e fajësis nga ana e të akuzuarëve i cili është bërë në përputhje të plot me dispozitat ligjore të KPP-së, i cili pajtim poashtu ka mbështetje të plot ligjore nga neni 248, të KPK-së, si dhe në prova materjale të cilat i përmban aktakuza, Prokurori i shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësis nga ana e të akuzuarëve. Poashtu thekson duke pasur parasysh raportet në mes palëve, si dhe pendimin e thellë, poashtu edhe fjalën e të dëmtuarit të cilët gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të njëjtit kanë arritur pajtim, duke ja shtrirë njëri tjetëri dorën.

Mbrojtësi i të demturit Av. N. H. dhe i dëmtuari K. M. në fjalën përfundimtare kanë deklaruar se mbështesin fjalën përfundimtare të Prokurorit duke theksuar i dëmtuari se të akuzuarit D. dhe B. E. ka nipa dhe që në të ardhmen do të vazhdojn të kenë raporte të mira familjare dhe do të ketë respekt ndaj të tyre.

Të akuzuarit në fjalën e tyre përfundimtare kanë deklaruar se e pranojn fajësin dhe janë penduar thellë për akuzën për të cilën ngarkohen -për atë që ka ndodhur në mes tyre dhe se në këtë seanc gjyqësore në prezencën e gjykatës Prokurorit dhe organeve të sigurimit dëshmitarëve, të demturit, ja shtrin dorën e pajtimit duke i kërkuar falje dajës së tij K. M. këtu të dëmtuarit, duke i premtuar dhe zotuar se në të ardhmen nuk do të përseriten veprime të tilla kunderligjore do të kenë qdo herë raporte të mira familjare, nip e daj si më parë, premtojn se nuk do ta ngacmojn por përkundrazi do ketë respekt dhe do ta ndihmojn në qdo mënyrë dhe rrethan të jetës duke i shprehur respekt të madh ndaj dajës së tij Kadri Muqaj këtu të dëmtuarit, dhe pohon se do të jenë në raporte të mira familjare.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 06.03.2015, rreth orës 14.50 min., në Prizren, në rrugën „P.“, nr. 16, në bashkëveprim, seriozishtë i kanosen personit tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do ti shkaktojn ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose shkakimit të ankthit, të dëmtuarit K. M. në atë mënyrë që derisa i njëjti ishte afër shtëpis së tij se bashku me një person tjetër përshkak të një ndërtimit të një objekti në afërsi të shtëpis së të pandehurëve në momentin kur takohen i kanosen me fjalët: „ bahu prej ketuhit, se kemi me të vra, dhe

ketë shtëpi kurrë s'ka me gzu", me q' rastë tek i dëmtuari shkaktojn ankth dhe frikë si dhe i arrezikojn sigurin personale.

Nga kjo del se në veprimet e akuzuarëve Dë [redacted] dhe Be [redacted] El [redacted] më afër të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi, formohen të gjitha elementet e veprës penale kanosje nga neni 185 parag.2, e lidhur me nenin 31, të KP.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimit i fajsisë të cilët në shqyrtimin gjyqësor vullnetarisht kanë pranuar fjasin, për shkak se cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se egziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se të akuzuarit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit për veprën penale e cila i'u vihet në barrë e që pranimit i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështete në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat të akuzuarit kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimit i fajsisë nga ana e të akuzuarëve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarëve formohen të gjitha elementet e veprës penale kanosje nga neni 185 parag.2, e lidhur me nenin 31, të KP, dhe për këtë gjykata të akuzuarit i shpalli fajtorë dhe i'u shqiptoj vërejtje gjyqësore duke e vërtetuar përgjegjësinë e tyre penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarëve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimit i fajsis nga ana e akuzuarëve, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, kanë lidhje familjare, jan nip e dajë, jan pajtuar duke ja shtrirë doren njëri tjetërit, janë penduar thellë për veprimet e bëra, keq ardhjen e shfaqur nga ana e personave të denuar, raportet në mes palëve, të akuzuarëve dhe të demtuarit, duke pasur parasysh se janë nip e dajë, andaj Gjykata pati parasysh faktin që të të dy të akuzuarëve të i'u shqiptohet ky lloj i sanksionit që të mos acarohen më teper raprtet familjare të palëve, në këtë rastë nipit dhe dajës, si dhe peshen e vepres penale dhe llojin e saj. Andaj Gjykata i'u shqiptoj vërejtje gjyqësore, duke i bërë me dije të akuzuarit se kanë kryer veper të dëmshme dhe të rrezikëshme, që përbën veper penale dhe nëse kryejn prap veper të tillë gjykata do ti shqiptoj sanksion më të rënd penal, duke menduar se vërejtja gjyqësore i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këtë qortim-dënim, do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesëshëm, dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 451, të KPP-së.

Nga të cekurta më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.575/15, të datës 08.03.2017**

**Sekretare Juridike**  
**Mire Beqiraj**

**Gjyqtari**  
**Gani-Kastrati**

**UDHËZIME JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.